Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 41
Bujqësia

Objektivi

Objektivi i këtij Standardi është përshkrimi i trajtimit kontabël dhe dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me aktivitetin bujqësor.

Objekti

1 **Ky standard do të zbatohet për kontabilizimin e mëposhtë listuarave në lidhje me aktivitetin bujqësor:**

(a) aktivet biologjike, me përjashtim të bimëve bartëse;

(b) prodhimin bujqësor në momentin e të vjelave/korrave; dhe

(c) grantet qeveritare të përshkruara në paragrafët 34 dhe 35.

2 Standardi nuk zbatohet për:

(a) tokën e lidhur me veprimtarinë bujqësore (shih SNK 16 *Toka, ndërtesa, makineri e pajisje* dhe SNK 40 *Aktiv afatgjatë material i investuar*).

(b) bimët bartëse të lidhura me veprimtarinë bujqësore (shih SNK 16). Megjithatë ky Standard zbatohet për prodhimin e këtyre bimëve bartëse.

(c) grantet qeveritare të lidhura me bimët bartëse (shih SNK 20 *Kontabiliteti i granteve qeveritare dhe paraqitja e informacioneve për ndihmën qeveritare*).

(d) aktivet jo-materiale të lidhura me veprimtarinë bujqësore (shih SNK 38 *Aktivet jomateriale*).

(e) aktivet me të drejtë përdorimi të cilat vijnë nga një qira e tokës që lidhet me aktivitetin bujqësor (shih SRNF 16 *Qiratë*).

3 Ky Standard zbatohet për prodhimin bujqësor, i cili është produkti i të vjelave/korrave të aktiveve biologjike të njësive ekonomike vetëm në momentin e të vjelave/korrave. Për çdo rast tjetër zbatohet SNK 2 *Inventarët* ose çdo Standard tjetër i zbatueshëm. Si rrjedhojë ky Standard nuk trajton përpunimin e prodhimit bujqësor pas të vjelave/korrave; për shembull, përpunimi i rrushit në verë nga një tregtar vere që ka kultivuar rrushin. Një përpunim i tillë nuk përfshihet në përkufizimin e këtij Standardi për veprimtarinë bujqësore edhe pse një përpunim i tillë mund të jetë vazhdim logjik dhe i natyrshëm i veprimtarisë bujqësore dhe çdo proces përpunimi mund të mbartë ngjashmëri me transformimin biologjik.

4 Tabela e mëposhtme jep shembuj të aktiveve biologjike, prodhimit bujqësor dhe produkteve që vijnë si rezultat i përpunimit pas të vjelave/korrave:

Aktivet biologjike	**Prodhimi bujqësor**	**Produkte që rezultojnë nga përpunimi pas të vjelave/korrave**
Dele	Lesh	Fije leshi, qilim
Pemë në një plantacion të lëndëve drusore pyjor	Trungje	Lëndë drusore
Lopë qumështi	Qumësht	Djathë
Derra	Stërvinë (e kafshës së ngordhur)	Salçiçe, proshutë e tymosur
Bimë pambuku	Pambuk i vjelë	Fije pambuku, veshje
Kallamsheqeri	Kallam sheqeri i mbledhur (korrur)	Sheqer
Bimë duhani	Gjethe të mbledhura	Cigare
Shkurre çaji	Gjethe të mbledhura	Çaj

Aktivet biologjike	Prodhimi bujqësor	Produkte që rezultojnë nga përpunimi pas të vjelave/korrave
Hardhi	Rrush	Verë
Pemë frutore	Fruta të vjela	Fruta të përpunuara
Palma për vaj	Fruta të vjela	Vaj palme
Pemë kauçuku	Lëndë kauçuku e mbledhur	Prodhime gome
Zakonisht, disa bimë si për shembull shkurret e çajit, vreshtat e rrushit, palmat e vajit dhe pemët e kauçukut, e plotësojnë përkufizimin e një bime bartëse dhe janë brenda objektit të SNK 16. Megjithatë prodhimi i rritur në bimët bartëse, si për shembull gjethet e çajit, rrushi, vaji i palmës, frutat dhe lënda e kauçukut, është brenda objektit të SNK 41.		

Përkufizimet

Përkufizime në lidhje me bujqësinë

5 **Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:**

Aktivitete bujqësor **është menaxhimi nga një njësi ekonomike i transformimit biologjik dhe të korrat e aktiveve biologjike për shitje ose konservim në prodhimin bujqësor ose një aktive shtesë biologjike.**

Prodhimi bujqësor **është produkti i të vjelave/korrave të aktiveve biologjike të njësisë ekonomike.**

Një *bimë bartëse* është një bimë e gjallë e cila:

(a) përdoret në prodhimin ose ofrimin e prodhimit bujqësor;

(b) pritet që të japë prodhim gjatë më shumë se një periudhe; dhe

(c) ka pak shanse të shitet si prodhim bujqësor, me përjashtim të shitjes aksidentale si mbeturinë.

Një *aktiv biologjik* është gjëja e gjallë ose bima.

Procesi i transformimit biologjik **përfshin proceset e rritjes, zëvendësimit, prodhimit dhe riprodhimit që krijon ndryshime cilësore dhe sasiore në një aktiv biologjik.**

Kostot e shitjes **janë kostot shtesë që i atribuohen direkt shitjes së një aktivi, duke përjashtuar kostot financiare dhe taksat mbi të ardhurat.**

Një grup aktivesh biologjike **është një bashkim i të mbjellave të ngjashme dhe gjësë së gjallë të ngjashme.**

Të vjelat/korrat **janë shkëputja e prodhimit prej një aktivi biologjik ose pushimi i proceseve të jetës të aktivit biologjik.**

5A Nuk janë bimë bartëse sa vijon:

(a) bimët e kultivuara për t'u vjelë\korrur si prodhim bujqësor (për shembull, pemët e kultivuara për lëndën drusore);

(b) bimët e kultivuara për prodhimin e produkteve bujqësore kur ka mundësi që njësia ekonomike ta vjelë\korrë si dhe ta shesë bimën si prodhim bujqësor, dallueshëm nga shitja aksidentale si mbeturinë (si për shembull, pemët që kultivohen si për frutat e tyre ashtu edhe për lëndën drusore); dhe

(c) të korrat vjetore (si për shembull, misri dhe gruri).

5B Nëse bimët bartëse nuk përdoren më për prodhim, ato mund të priten dhe shiten si mbeturinë, për shembull për t'u përdorur si dru për zjarr. Një shitje e tillë aksidentale nuk pengon bimën në plotësimin e përkufizimit të bimës bartëse.

5C Prodhimi i rritur në një bimë bartëse është një aktiv biologjik.

6 Aktiviteti bujqësor përmbledh një gamë të shumëllojshme aktivitetesh; si për shembull rritjen e kafshëve, pylltarinë, të mbjellat vjetore ose të vazhdueshme, kultivimin e pemëve ose të bimëve, frutikulturën,

 © Fondacioni i SNRF-ve

akuakulturën (duke përfshirë dhe rritjen e peshkut). Ekzistojnë disa tipare të përbashkëta brenda këtij diversiteti:

(a) *Aftësia për të ndryshuar.* Kafshët e gjalla ose bimët janë në gjendje të pësojnë transformim biologjik;

(b) *Drejtimi i ndryshimit.* Drejtimi ndihmon transformimin biologjik duke rritur ose të paktën stabilizuar kushtet e nevojshme për procesin e ndodhur (për shembull ushqimi, lagështia, temperatura, pjelloria dhe drita). Një drejtim i tillë dallon veprimtarinë bujqësore nga veprimtaritë e tjera. Për shembull, mbledhja nga burime të pakontrolluara (si peshkimi në oqean apo shpyllëzimi) nuk konsiderohen veprimtaritë bujqësore; dhe

(c) *Matja e ndryshimit.* Ndryshimi në cilësi (për shembull, cilësitë gjenetike, dendësia, pjekuria, shtresa e dhjamit, përmbajta me proteina, dhe fortësia e fibrës) ose në sasi (për shembull, pasardhësi, pesha, volumi, gjatësia ose diametri i fibrës, dhe numri i sythave) që vijnë si rezultat i transformimit biologjik matet dhe monitorohet si një funksion i përditshëm menaxherial.

7 Transformimi biologjik paraqitet në rezultatet e mëposhtme:

(a) aktivi ndryshon përgjatë (i) rritjes (një rritje në madhësi ose përmirësim në cilësinë e kafshës së gjallë ose bimës), (ii) zvetënimit (një rënie në sasi ose përkeqësim i cilësisë së kafshës së gjallë ose bimës), ose (iii) riprodhimi (krijimi i kafshëve dhe bimëve shtesë); ose

(b) prodhimi i produktit bujqësor si për shembull lëngu qumështor, gjethe çaji, lesh dhe qumësht.

Përkufizime të përgjithshme

8 Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:

***Vlera kontabël* (neto) është shuma me të cilën një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar.**

***Vlera e drejtë* është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. (Shih SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*.)**

***Grantet qeveritare*, siç përcaktohet në SNK 20.**

9 [Fshirë]

Njohja dhe matja

10 Njësia ekonomike do të njohë aktivin biologjik apo prodhimin bujqësor kur dhe vetëm kur:

(a) njësia ekonomike kontrollon aktivin si rezultat i ngjarjeve të kaluara;

(b) është e mundshme që në njësi ekonomike të hynë përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me aktivin; dhe

(c) kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

11 Në prodhimin bujqësor, kontrolli mund të dështohet nga, për shembull, pronësia ligjore mbi gjedhët dhe damkosja ose përndryshe shënjimi i gjedhëve në pronësi apo të lindura. Normalisht, përfitimet e ardhshme vlerësohen duke matur cilësitë më të spikatura fizike.

12 Një aktiv biologjik duhet të matet në njohjen fillestare dhe në fund të çdo periudhe raportuese me vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes, përveçse rastit të paraqitur në paragrafin 30 ku vlera e drejtë është e pamatshme në mënyrë të besueshme.

13 Prodhimi bujqësor i korrur/vjelur nga aktivet biologjike të njësisë ekonomike do të matet me vlerën e vet të drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes në momentin e të vjelave/korrave. Një matje e tillë është kosto në datën e zbatimit të SNK 2 *Inventarët* ose të një Standardi tjetër të zbatueshëm.

14 [Fshirë]

15 Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktivit biologjik ose prodhimit bujqësor mund të lehtësohet duke bërë grupimin e aktiveve biologjike ose prodhimit bujqësor sipas karakteristikave më të spikatura; për shembull, sipas moshës ose cilësisë. Një njësi ekonomike zgjedh veçori të cilat mund të korrespondojnë me veçori të përdorura si bazë për vendosjen e çmimit në treg.

16 Shpesh, njësitë ekonomike hyjnë në marrëveshje kontraktuale për shitjen e aktiveve biologjike ose prodhimit bujqësorë në një datë të ardhme. Çmimet e kontratave nuk janë domosdoshmërisht të përshtatshme për të përcaktuar vlerën e drejtë për aq kohë sa vlera e drejtë reflekton vetëm tregun aktual në

të cilin një blerës dhe një shitës janë të gatshëm të hyjnë në një transaksion. Si rezultat, vlera e drejtë e aktivit biologjik ose prodhimit bujqësor nuk ndryshohet për shkak të ekzistencës së një kontrate. Ka raste kur një kontratë e lidhur për shitjen e një aktivi biologjik ose prodhimi bujqësor mund të jetë një kontratë me kushte rënduese, siç përkufizohet në SNK 37 *Provizionet, detyrimet e kushtëzuara. dhe aktivet e kushtëzuara.* SNK 37 zbatohet për kontratat me kushte rënduese.

17-21 [Fshirë]

22 Njësia ekonomike nuk i përfshin flukset monetare për financimin e aktiveve ose rindërtimit të aktiveve biologjike pas vjeljeve/korrjeve (për shembull, kosto e ri mbjelljes së pemëve në një pyll plantacionesh pas prerjes).

23 [Fshirë]

24 Mundet që kosto të jetë e përafërt me vlerën e drejtë sidomos kur:

(a) ndodh një transformim i vogël biologjik që prej momentit të kostove fillestare (për shembull, kur pemët frutore fidanët mbillen vetëm pak para fundit të periudhës raportuese ose gjëja e gjallë e sapo blerë); ose

(b) ndikimi në çmimi i transformimit biologjik nuk pritet të jetë material (për shembull, gjatë rritjes fillestare të ciklit të prodhimit të një plantacioni 30 vjeçar pishash).

25 Shpesh, aktivet biologjike lidhen fizikisht me tokën (për shembull, pemët me pyllin e plantacionit). Mund të mos ekzistojë një treg i ndarë për aktivet biologjike që janë të bashkangjitura me tokën, megjithatë ekziston një treg aktiv për aktivet e kombinuara, që janë, aktivet biologjike, toka e papunuar, dhe përmirësimet e tokës, si një paketë. Njësia ekonomike përdor informacionin në lidhje me aktivet e kombinuara në përcaktimin e vlerës së drejtë të aktiveve biologjike. Për shembull, vlera e drejtë e tokës së papunuar dhe përmirësimet e tokës mund të zvogëlohen prej vlerës së drejtë të aktiveve të kombinuara për të arritur në vlerën e drejtë të aktiveve biologjike.

Fitimet dhe humbjet

26 Fitimi ose humbja të krijuara në njohjen fillestare të një aktivi biologjik në vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes dhe nga një ndryshim në vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes së një aktivi biologjik, do të përfshihen në fitimin ose humbjen e periudhës kur janë kryer.

27 Humbja mund të krijohet në njohjen fillestare të aktivit biologjik për shkak se kostot e vlerësuara të shitjes janë zbritur në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes së një aktivi biologjik. Një fitim mund të krijohet në njohjen fillestare të aktivit biologjik, si për shembull në rastin e lindjes së një viçi.

28 Një humbje ose një fitim i krijuar në njohjen fillestare të prodhimit bujqësor në vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes, do të përfshihen në fitimin ose humbjen e periudhës në të cilën krijohen.

29 Një fitim ose humbje mund të krijohet në njohjen fillestare të prodhimit bujqësor si rezultat i vjeljeve/korrjeve.

Pamundësia për matje të besueshme të vlerës së drejtë

30 Ekziston një supozim se vlera e drejtë mund të matet në mënyrë të besueshme për një aktiv biologjik. Megjithatë ky supozim mund të hidhet poshtë vetëm kur nuk disponohen çmimet ose vlerat e paracaktuara nga tregu të një aktivi biologjik në momentin e njohjes fillestare, dhe për të cilën nuk mund të përcaktohen qartësisht në mënyrë të besueshme vlerësime alternative të vlerës së drejtë. Në një rast të tillë, ky aktiv biologjik do të matet në koston e vet minus çdo shumë amortizimi të akumuluar ose humbje të akumuluara të zhvlerësimit. Sapo që vlera e drejtë e një aktivi të tillë biologjik bëhet besueshmërisht i matshëm, një njësi ekonomike do ta masë në vlerën e vet të drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes. Sapo që një aktiv afatgjatë jo-biologjik kënaq kriteret për t'u klasifikuar në cilësinë e mbajtjes për shitje (ose përfshihet në një grup për t'u nxjerrë jashtë përdorimit që është i klasifikuar si i mbajtur për shitje), në përputhje me SNRF 5 *Aktivet afatgjata që mbahen për t'u shitur dhe operacionet jo të vijueshme*, vlera e drejtë e këtij aktivi do të konsiderohet besueshmërisht i matshëm.

31 Në paragrafin 30, ky konsiderim do të hidhej poshtë vetëm në njohjen fillestare. Një njësi ekonomike, e cila e ka matur më parë aktivin biologjik në vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes, do të vazhdojë ta masë aktivin biologjik në vlerën e vet të drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes derisa të dalë jashtë përdorimit.

 © Fondacioni i SNRF-ve

32 Në të gjitha rastet, një njësi ekonomike duhet të masë prodhimin bujqësor në momentin e të vjelave/korrave në vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes. Ky Standard reflekton këndvështrimin e matjes së përhershme në mënyrë të besueshme të prodhimit bujqësor në momentin e të vjelave/korrave.

33 Në përcaktimin e kostos, amortizimit të akumuluar dhe humbjeve të akumuluara të zhvlerësimit, një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë SNK 2, SNK 16 dhe SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve.*

Grantet qeveritare

34 Një grant qeveritar i pakushtëzuar i dhënë në lidhje me një aktiv biologjik të matur në vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes do të njihet si e ardhur kur dhe vetëm kur granti qeveritar kthehet në të drejtë të arkëtueshme.

35 Në rast se një grant qeveritar i dhënë në lidhje me një aktiv biologjik i matur në vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes, është i kushtëzuar dhe kërkon që njësia ekonomike të mos jetë e përfshirë në një aktivitet bujqësor të specifikuar, atëherë njësia ekonomike do ta njohë grantin qeveritar si një të ardhur kur dhe vetëm kur kushtet bashkangjitur këtij granti janë plotësuar.

36 Kushtet e granteve qeveritare janë të ndryshme. Për shembull, një grant qeveritar mund të kërkojë që një njësi ekonomike të punojë në një vendndodhje të caktuar për pesë vjet dhe gjithashtu të kthejë shumën e grantit qeveritar në rast se tërhiqet para periudhës pesëvjeçare. Në këtë rast, granti qeveritar nuk do të njihet si e ardhur deri sa të kalojë periudha pesë-vjeçare. Megjithatë, nëse granti qeveritar lejon që një pjesë e kësaj shume të mbahet me kalimin e kohës, njësia ekonomike duhet të njohë grantin qeveritar si të ardhur të shpërndarë në kohë.

37 Në rast se granti qeveritar në lidhje me një aktiv biologjik matet në koston e vet minus çdo amortizim të akumuluar ose humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (shih paragraf 30), atëherë duhet zbatuar SNK 20.

38 Ky Standard kërkon një trajtim të ndryshëm nga SNK 20, nëse granti qeveritar i lidhur me një aktiv biologjik matet në vlerën e vet të drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes ose granti qeveritar kërkon nga njësia ekonomike që të mos angazhohet në një aktivitet të veçantë bujqësor. SNK 20 zbatohet vetëm në rastin kur një grant qeveritar në lidhje me një aktiv biologjik matet në koston e vet minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

39 [Fshirë]

Të përgjithshme

40 Njësia ekonomike do të paraqesë në shënimet shpjeguese totalin e fitim humbjes që vjen nga njohja fillestare e aktiveve biologjike dhe prodhimit bujqësor gjatë periudhës aktuale, dhe nga ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes të aktiveve biologjike.

41 Njësia ekonomike duhet të sigurojë një përshkrim të qartë të çdo grupi të aktiveve biologjike.

42 Dhënia e informacioneve shpjeguese e kërkuar në paragrafin 41 mund të marrë formën e një përshkrimi tregimtar ose sasior.

43 Njësia ekonomike inkurajohet të japë një përshkrim sasior për çdo grup aktivesh biologjike, që bën dallimin e aktiveve biologjike të konsumueshme me ato prodhuese, ose të aktiveve biologjike të rritura dhe të parritura. Për shembull, njësia ekonomike mund të japë të dhëna shpjeguese për vlerën kontabël (neto) të aktiveve biologjike të konsumueshme dhe të aktiveve biologjike prodhuese për çdo grup. Për më tepër, njësia ekonomike mund t'i ndajë këto vlera kontabël (neto) edhe midis aktiveve të rritura dhe të parritura. Këto dallime japin informacion të nevojshëm dhe ndihmës për vlerësimin e kohës së rrjedhave të ardhshme të mjeteve monetare. Njësia ekonomike jep të dhëna shpjeguese edhe për bazat mbi të cilat ngrihen këto dallime.

44 Aktivet biologjike të konsumueshme janë ato aktive që lidhen me të vjelat/korrat si prodhim bujqësor ose që shiten si aktive biologjike. Shembuj të tyre janë: gjëja e gjallë e rritur me qëllimin e prodhimit të mishit, gjëja e gjallë e mbajtur për shitje, peshku i kultivuar, të mbjellat si misri dhe gruri, prodhimi i një bime bartëse dhe pemët që rriten për lëndën drusore. Aktive biologjike prodhuese janë gjithë të tjerat, të ndryshme nga aktivet biologjike të konsumueshme; për shembull, gjëja e gjallë prej të cilës prodhohet qumështi dhe pemët frutore prej të cilave prodhohen frutat. Aktivet biologjike prodhuese nuk konsiderohen prodhim bujqësor, por si vetë-rigjeneruese të mbajtura për të vjelë prodhim.

45 Aktivet biologjike mund të klasifikohen si aktive biologjike të rritura ose si aktive biologjike të parritura. Aktivet biologjike të rritura janë ato aktive të cilat realizohen për veçori në korrje/vjelje (aktive biologjike të konsumueshme) ose që janë në gjendje që të ruajnë nivele të qëndrueshme të korrjeve/vjeljeve (aktivet biologjike prodhuese).

46 Një njësi ekonomike do të japë dhe informacionin shpjegues vijues, nëse ky informacion nuk është paraqitur diku tjetër në informacionin e publikuar me pasqyrat financiare:

(a) natyrën e aktiviteteve që përfshijnë çdo grup i aktiveve biologjike; dhe

(b) matjet ose vlerësimet jo-financiare të sasive fizike të:

(i) çdo grupi të aktiveve biologjike të njësisë ekonomike në fund të periudhës; dhe

(ii) rezultatet e prodhimit bujqësor gjatë periudhës.

47-48 [Fshirë]

49 Njësia ekonomike jep si informacion shpjegues:

(a) ekzistencën dhe vlerën kontabël (neto) të aktiveve jo-materiale për të cilat titulli i pronësisë është i kufizuar dhe vlerat kontabël (neto) të aktiveve jo-materiale të vëna si garantues të detyrimeve;

(b) shumën e angazhuar për zhvillimin ose blerjen e aktiveve biologjike; dhe

(c) strategjitë e drejtimit të rrezikut financiar në lidhje me veprimtarinë bujqësore.

50 Njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues një rakordim të ndryshimeve të vlerës kontabël (neto) të aktiveve biologjike në fillim dhe në fund të periudhës aktuale. Rakordimi do të përfshijë:

(a) fitimin ose humbjen që lind nga ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot e shitjes;

(b) rritjet për shkak të blerjeve;

(c) rëniet e shitjeve dhe të aktiveve biologjike si të mbajtura për shitje (ose të përfshira në një grup për t'u nxjerrë jashtë përdorimit të klasifikuara si të mbajtura për shitje) në përputhje me SNRF 5;

(d) rëniet në të vjela/korra;

(e) rritjet që rezultojnë nga kombinimet e bizneseve.

(f) diferencat neto nga këmbimi që vijnë nga përkthimi i pasqyrave financiare në një monedhë të ndryshme paraqitjeje dhe nga përkthimi i operacioneve jashtë vendit në monedhën e paraqitjes të njësisë ekonomike; dhe

(g) ndryshime të tjera.

51 Vlera e drejtë minus kostot e vlerësuara në shitje të aktivit biologjik mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve fizike si dhe ndryshimeve të çmimit në treg. Dhënia më vete e informacioneve shpjeguese mbi ndryshimet fizike dhe të çmimit ndihmojnë në vlerësimin e performancës gjatë periudhës dhe perspektivave të ardhshme, sidomos kur bëhet fjalë për një cikël prodhimi bujqësor më të gjatë se një vit. Në të tilla raste njësia ekonomike inkurajohet që të japë informacione shpjeguese sipas grupit ose përndryshe shumën e ndryshimit të vlerës së drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes të përfshira në fitim ose humbje për shkak të ndryshimeve fizike dhe ndryshimeve të çmimeve. Ky informacion është përgjithësisht më pak i dobishëm në rastin e një cikli prodhimi më të gjatë se një vit (për shembull rritja e pulave ose e të mbjellave të drithërave).

52 Transformimi biologjik rezulton në lloje të ndryshme të ndryshimit fizik—rritja, zvetënimi, prodhimi dhe riprodhimi, ku secila prej tyre është e dukshme dhe e matshme. Secila prej këtyre ndryshimeve fizike ka lidhje direkte me përfitimet e ardhshme ekonomike. Një ndryshim në vlerën e drejtë të aktivit biologjik për shkak të të vjeljeve/ korrjeve, do të konsiderohet gjithashtu një ndryshim fizik.

53 Aktiviteti bujqësor shpesh ekspozohet ndaj rreziqeve klimatike, sëmundjeve dhe rreziqeve të tjera natyrore. Nëse ndodh një ngjarje e cila rrit materialisht zërin e të ardhurave ose shpenzimeve, natyra dhe shuma e saj duhet të jepet si informacion shpjegues në përputhje me SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare.* Të tillë shembuj përfshijnë rënien e një sëmundjeje vdekjeprurëse, përmbytje, thatësirë ose ngricë të fortë dhe murtajë insektesh.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Dhënie informacionesh shpjeguese shtesë për aktivet biologjike ku vlera e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri

54 **Nëse njësia ekonomike i mat aktivet biologjike në koston e tyre minus çdo amortizim të akumuluar dhe humbje të akumuluar zhvlerësimi (shih paragrafin 30) në fund të periudhës, atëherë njësia ekonomike do të japë të dhëna shpjeguese për këto aktive biologjike:**

(a) një përshkrim të aktiveve biologjike;

(b) një shpjegim se pse vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme;

(c) nëse është e mundur, gamën e vlerësimeve sipas së cilës vlera e drejtë ka gjasa të mos jetë e vërtetë;

(d) metodën e përdorur të amortizimit;

(e) jetët e dobishme ose normat e amortizimit të përdorura; dhe

(f) vlerën kontabël bruto dhe çdo amortizim të akumuluar (të mbledhur me humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi) në fillim dhe në fund të periudhës.

55 **Nëse, gjatë periudhës aktuale, njësia ekonomike mat aktivet biologjike në kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe humbje të akumuluar zhvlerësimi (shih paragrafin 30), ajo do të paraqesë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare çdo humbje ose fitim të njohur gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit të këtyre aktiveve biologjike si dhe rakordimin e kërkuar nga paragrafi 50, që do të japë informacion shpjegues në lidhje me shumat e veçanta të këtyre aktiveve biologjike. Veç kësaj, rakordimi do të përfshijë shumat e mëposhtme të përfshira në fitimin apo humbjen e lidhur me këto aktive biologjike:**

(a) humbjet nga zhvlerësimi;

(b) kthimet mbrapsht të humbjeve nga zhvlerësimi; dhe

(c) amortizimin.

56 **Nëse vlera e drejtë e aktiveve biologjike e matur më parë me kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe humbje të akumuluar zhvlerësimi bëhet besueshmërisht e matshme gjatë periudhës aktuale, atëherë njësia ekonomike do të paraqesë shënimet shpjeguese të këtyre aktiveve biologjike në pasqyrat financiare si më poshtë:**

(a) një përshkrim të aktiveve biologjike;

(b) një shpjegim të arsyes të mos matjes në mënyrë të besueshme të vlerës së drejtë; dhe

(c) efektin e ndryshimit.

Grantet qeveritare

57 **Njësia ekonomike do të paraqesë si më poshtë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare në lidhje me veprimtarinë bujqësore të mbuluar nga ky Standard:**

(a) natyrën dhe madhësinë e granteve qeveritare të njohura në pasqyrat financiare;

(b) kushtet e paplotësuara dhe eventualitete të tjera bashkangjitur granteve qeveritare; dhe

(c) pakësimet e rëndësishme të pritura në nivelin e granteve qeveritare.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

58 Ky Standard bëhet operativ për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat vjetore që fillojnë më datë 1 janar 2003 ose më pas. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon më parë se 1 janar 2003, do të jap informacion shpjegues për këtë fakt.

59 Ky Standard nuk krijon asnjë dispozitë kalimtare të veçantë. Adoptimi i këtij Standardi bëhet në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.* [1]

60 Paragrafët 5, 6, 17, 20 dhe 21 janë ndryshuar dhe paragrafi 14 është fshirë me *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2009. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi

[1] Kur publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* në prill 2024, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

61 SNRF 13, i publikuar në maj 2011, ndryshoi paragrafët 8, 15, 16, 25 dhe 30 dhe fshiu paragrafët 9, 17-21, 23, 47 dhe 48. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.

62 *Bujqësia: Bimët bartëse* (Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41), i publikuar në qershor 2014, ndryshoi paragrafët 1–5, 8, 24 dhe 44 dhe shtoi paragrafët 5A–5C dhe 63. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016 e në vijim. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8.

63 Nëse në periudhën e raportimit *Bujqësia: Bimët bartëse* (Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 41) zbatohet për herë të parë, një njësi ekonomike nuk ka nevojë të japë informacionin shpjegues sasior të kërkuar nga paragrafi 28(f) i SNK 8 për periudhën aktuale. Megjithatë, një njësi ekonomike do të paraqesë informacionin shpjegues sasior të kërkuar nga paragrafi 28(f) i SNK 8 për çdo periudhë të mëparshme të paraqitur.

64 SNRF 16, e publikuar në janar 2016, ndryshoi paragrafin 2. Njësia ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

65 *Përmirësime vjetore të standardeve SNRF 2018-2020*, të publikuara në maj 2020, ka ndryshuar paragrafin 22. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim të matjes së vlerës së drejtë në datën e periudhës së parë raportuese që fillon në datën 1 janar 2022 ose më pas. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

66 SNRF 18, i publikuar në prill 2024, ndryshoi paragrafët 50 dhe 53. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

 © Fondacioni i SNRF-ve